



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.937/ 10 Prot.,

Datë 14.05.2025

V E N D I M
Nr. 662 / 2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.05.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Loti II** me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “*Blerje tonera*”, me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ERVIN LUZI” P.F, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ERVIN LUZI” P.F, në procedurën e mësipërme të prokurimit

Ankimues:

Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK me Nipt, K81503063B, Adresa: Rr: Faik Konica, Ndërtesa nr.3, Hyrja 7, Tiranë.

Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” ShPK, me Nipt L91418502J, Adresa: Z.Kadastrale nr.8517, Ndërtese 4 kate, me sip. truall 1000 m², Durrës.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Durrës.
Adresa: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “ERVIN LUZI” P.F, me Nipt. K71707007Q, Adresa: Lagjja:Katund i Ri, Rr. Ali Pashë Gucia, Nr. 5,Yrshek, Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” ShPK, me Nipt L91418502J, Adresa: Z.Kadastrale nr.8517, Ndërtese 4 kate, me sip. truallli 1000 m², Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues për të njëjtën procedurë prokurimi ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave.

I.5. Operatori ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” ShPK nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 05.03.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, **Loti II** me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “*Blerje tonera*”, me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 26.03.2025 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në SPE dhe ka kryer renditjen e tyre si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1-InfoSoft Office Shpk	1,542,890	Skualifikuar
2- MARKETING & DISTRIBUTION Shpk	1,600,000	Skualifikuar
3- ADD GROUP Shpk	1,778,900	Skualifikuar
4- IT Gjergji Kompjuter Shpk	1,797,000	Skualifikuar
5- LIBRARI DYRRAHU Shpk	1,970,000	Kualifikuar
6-Alpha Procurement Shpk	2,190,400	Skualifikuar
7-Blueprint Technologies Shpk	2,190,400	Skualifikuar
8- ERVIN LUZI P.F.	2.567,500	Kualifikuar
9-BNT ELECTRONICS Shpk	3,911,100	Kualifikuar
10-MOND OFFICE Shpk	4,700,800	Skualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë **04.04.2025** ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5228, datë 09.04.2025 dhe me Nr. 937/2025 Prot., datë 09.04.2025 e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. Loti II me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “*Blerje tonera*”, me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” ShPK si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertaës së paraqitur nga operatori ekonomik “ERVIN LUZI” P.F, në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij,

të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 937/1 prot., datë 10.04.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.6. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me shkresat ardhur në sistem, protokolluar me tonën me nr. 937/2, dhe 937/3 datë 14.04.2025 me objekt “Formular i paraqitjes së argumenteve”, operatori ekonomik i interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK, kundërshton pretendimet e ankesës së operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK.

II.7. Me shkresën nr. 937/4 Prot., datë 23.04.2025, drejtuar autoriteti kontraktor, Komisioni kërkoi Vendimin e KSHA-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, për procedurën e prokurimit.

II.8. Me shkresën ardhur me postë me Nr. 1299/19 Prot., datë 23.04.2025, protokolluar me tonën me Nr.937/5, datë 24.04.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë:

Vendimin e KSHA-së me Nr.1299/16 Prot., datë 18.04.2025.

Dokumente të tjera në lidhje me hapjen e ofertave dhe vlerësimin e tyre si edhe

Dokumentet provuese të ofertës së operatorit ekonomik i renditur i pari.

Referuar Vendimit sipërcituar KSHA ka vendosur pranimin e ankesës.

II.9. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5276, datë 28.04.2025 dhe me Nr. 1101/2025 Prot., datë 28.04.2025 e operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Loti II me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “Blerje tonera ", me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.1299/16 Prot., datë 18.04.2025.

II.10. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1101/1 prot., datë 29.04.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.10.1. Me shkresën ardhur me e-mail pranë KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 1101/2, datë 30.04.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë informacionin në lidhje me ankesën e OE “LIBRARI DYRRAHU” ShPK e cila nuk është në kompetencë të AK-së për tu trajtuar.

II.11.Me shkresën Nr. 937/6 Prot., datë 29.04.2025, Komisioni i drejtohet Autoritetit Kontraktor, në lidhje me paqartësitë e konstatuara në përmbajtjen e Vendimit të KSHA-së.

II.12. Me shkresën Nr.1299/28, datë 06.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 937/7, datë 07.05.2025, me objekt: Informacion, Autoriteti Kontraktor ka përcjellë Informacion në lidhje me vendimin e KSHA-së.

II.13. Referuar dosjes administrative, në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nuk ka pretendime nga operatorë të tjerë të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, me anë të së cilës kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, argumentuar si vijon:

[...] 26.03.2025 jemi njohur me renditjen, me date 04.04.2025 është publikuar njoftim fituesi L.Dyrrahu, brenda afatit 7 ditor po paraqitim ankesë për kundërshtimin e Vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e Ervin Luzit,PF.

S’kualifikimi i ofertës tonë për shkak të formulës anomalisht të ulët lidhet dhe kushtëzohet vetëm nga kualifikimi apo skualifikimi i ofertuesve të tjerë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Ofertuesi i cili është shpallur fitues prapakisht në këtë procedurë prokurimi i cili është “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, me vlerë të ofertuar : 1,970,000 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, pra me vlerë të ofertës vetëm 173,000 lekë më të lartë se oferta jonë.

Në kushtet kur oferta e paraqitur nga shoqëria jonë është e s’kualifikuar vetëm për shkak të vlerës së saj të konstatuar si anomalisht e ulët, shoqëria jonë paraqet këtë ankesë duke e kundërshtuar këtë s’kualifikim i cili lidhet me mënyrën se si KVO ka vlerësuar ofertuesit e tjerë pjesmarrë në këtë procedurë prokurimi.

Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana e shoqërisë tonë vlerësojmë se, vjen si pasojë e një vlerësimi të bërë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentat e tenderit objekt i këtij ankimi të ofertuesve të cilët kanë paraqitur oferta në këtë procedurë prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në autoritetin kontraktor ka s’kualifikuar ofertën e paraqitur nga shoqëria “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, me arsyen për skualifikim: ”... për arsye se konsiderohet si ofertë anomalisht e ulët..”.

Ne besojmë se Ervin Luzi nuk ka paraqitur F.P.Vetedeklarimit

Në lidhje me deklarin si më sipër ne besojmë se, ofertuesi nuk ka plotësuar saktë llojin e dokumentit dhe adresën në WEB ku mund të merret informacioni apo të dhënat e deklaruara, në lidhje me deklarin e mësipërm ofertuesi Ervin Luzi PF, deklarimet si më sipër në rubrikat respektive të shtojcës 9 të DT-së nuk i ka plotësuar saktë dhe konform kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

*Pra, për deklarimet e mësipërme, **ne besojmë se**, nuk ka përcaktuar saktë ose nuk e ka përcaktuar fare dokumentin konkret provues si dhe adresën ku mund të verifikohet ky*

dokument apo deklarin, për të dhënat të cilat AK-ja mund të verifikojë dhe aksesojë direkt, informacionet e pasqyruara....

Pretendojmë se, operatori ekonomik pjesëmarrës “Ervin Luzi” Pf, në këtë procedurë prokurimi nuk i ka plotësuar kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, në lidhje me informacionet të cilat detyrimisht duhet të vendosen dhe deklarohen në shtojcën 9 të dt-së në, pra nuk ka arritur të paraqesë shtojcën 9 sipas kërkesës në pikën 2/1.a të shtojcës 8 të dtsë, pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos dhënë të dhëna që ky formular detyrimisht parashikon dhe kërkon.. [...]

Nga ana e autoritetit kontraktor, në kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.2 të shtojcës 8 të DT-së është kërkuar:

“..2.4.2 operatori ekonomik duhet të paraqes një deklaratë në të cilën merr përsipër lëvrimin e mallit pranë autotiretit kontraktor brenda afatit kohor. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST...”

III.1.1. Me shkresën ardhur me postë me Nr. 1299/19 Prot., datë. 23.04.2025, protokolluar me tonën me Nr.937/5, datë 24.04.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së me Nr.1299/16 Prot., datë 18.04.2025, Dokumente të tjera në lidhje me hapjen e ofertave dhe vlerësimin e tyre si edhe dokumentet provuese të ofertës së operatorit ekonomik i renditur i pari.

Referuar Vendimit të KSHA-së sipërcituar autoriteti kontraktor në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar si vijon: [...] OE ankues IT Gjergji Kompjuter në ankesë ka ngritur pretendimin per OE Ervin Luzi P.F.:

Komisioni pas verifikimit të ankesës konstatoi se ofertuesi “Ervin Luzi” P.F. nuk ka dhënë të dhëna të plota në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit...duke mos shoqëruar me adresë përkatëse.

Përsa më sipër gjykojmë se pretendimi i ankuesit qëndron, lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi “Ervin Luzi” P.F, Lidhur me deklarinet e “Ervin Luzi” P.F, për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, nuk ka plotësuar deklaratën sipas pikës 2/1, të shtojcës 9.

Përsa më sipër, lidhur me ankesën e OE, ankues “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, me Nipt. K81503063B, gjykojmë se ankesa duhet të refuzohet.

Për sa trajtuam më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, njëzëri, Vendosi 1. Pranimin e ankesës së ofertuesit “IT Gjergji Kompjuter” ShPK me Nipt. K81503063B, për kontratës me Nr. Loti II me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “Blerje tonera ", me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh....[...]

III.1.2. Me shkresën Nr. 937/6 Prot., datë 29.04.2025, Komisioni i drejtohet Autoritetit Kontraktor, në lidhje me paqartësi të konstatuara në përmbajtjen e Vendimit të KSHA-së. Në mënyrë të përmbledhur citon: [...] Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se përmbajtja e Vendimit Nr.1299/16, datë 18.04.2025 të KSHA-së ka paqartësi si në pjesën e trajtimit të pretendimeve edhe në pjesën e dispozitivit. Përsa më sipër Komisioni kërkon, nga autoriteti kontraktor, të sqarojë pretendimet e pranuar në Vendim e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës me numër ankimimi elektronik A/2025/5228, datë 09.04.2025 dhe me Nr. 937/2025 Prot., datë 09.04.2025 e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK. Informacioni i kërkuar të dërgohet brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese. [...]

III.1.3. Me shkresën Nr. 1299/28, datë 06.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 937/7, datë 07.05.2025, me anë të së cilës Autoriteti Kontraktor ka përcjellë pranë KPP-së Informacion në lidhje me ankesën si më poshtë vijon:

[...] Në përgjigje tuajës me nr. 937/6 prot., datë 29.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 1299/25, datë 02.05.2025, me lëndë: Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "IT Gjergji Kompjuter" ShPK, për procedurën e prokurimit "Procedurë Hapur e Thjeshtuar", me Nr. Loti II me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt "Blerje tonera ", me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, pasi u njohëm me përmbajtjen e shkresës sipërcituar , ju informojme si më poshtë vijon:

Referuar Vendimit të KSHA-së Nr. 1299/16 prot., datë 18.04.2025, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "IT Gjergji Kompjuter" ShPK, përcjell nga ana jonë me shkresën nr. 1299/19 prot., datë 23.04.2025, sqarojmë se në paragrafin e mëposhtëm është bërë një lapsus dhe duhet ndryshuar:

Ishte:

Përsa më sipër, lidhur me ankesën e OE, ankues "IT Gjergji Kompjuter" ShPK me Nipt K81503063B, gjykojmë se ankesa duhet të **refuzohet**.

Bëhet:

Përsa më sipër, lidhur me ankesën e OE, ankues "IT Gjergji Kompjuter" ShPK me Nipt K81503063B, gjykojmë se ankesa duhet të **pranohet**.

III.1.4. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcaktohet se: "1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

III.1.5. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- **Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.**
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.6. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që, *ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor*. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor i cili ka vendosur për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit, për ofertë me vlerë anomalisht të ulët..

Referuar Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi, E Hapur e Thjeshtuar, me objekt: “Blerje Kanceleri dhe Tонера”, **Loti II. Blerje Tонера**, me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, rezulton më vlerë të fondit limit nën kufirin e lartë monetar, referuar VKM-së Nr. 291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”.

Autoriteti kontraktor për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, e cila në aplikim të formulës rezulton anomalisht e ulët, në referim të parashikimeve e nenit 93 të LPP-së i ndryshuar shtuar pika: **(5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa**

kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”) e refuzon ofertën e cila është konstatuar anomalisht e ulët, pa kërkuar shpjegime.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ankesa e operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, oferta e të cilit rezulton të jetë ofertë anomalisht e ulët, duhet refuzuar, ndaj dhe pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Akoma më tej referuar pretendimeve të operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, edhe në rastin se hipotetikisht do të kishte të drejtë dhe pretendimet e parashtruara do të pranoheshin nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, sikurse referuar renditjes së paraqitur prej tij në ankesë ...1. InfoSoft Office, 2. Marketing & distribution, 3. Add Group, 4. It Gjergji Kompjuter ... duke rezultuar me vlerë oferte më të lartë nga OE e tjerë renditur përpara tij.

Përsa referuar më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” ShPK nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë dhe si rezultat edhe pretendimet e ankimuesit në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F nuk qëndrojnë.

Përsa argumentuar Komisioni gjykon se Vendimi KSHA-së duhet të shfuqizohet duke lënë në fuqi vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F.

III.2. Lidhur ankesën me numër ankimimi elektronik A/2025/5276, datë 28.04.2025 dhe me Nr. 1101/2025 Prot., datë 28.04.2025 të operatorit ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” ShPK, Ka argumentuar si vijon:

[...] Ankesë mbi Vendimin nr. 1299/16 date 18.04.2025 të Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës. Më datë 23.04.2025, nëpërmjet e-mail-it jemi njohur me vendimet e autoritetit kontraktor Bashkia Durrës, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitura nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-3986203-04-2025, me objekt “LOTI II Blerje Tonera”, zhvilluar më datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, me vendimin nr. 1299/16 prot., datë 18.04.2025 të KSHA-së pranimit të ankesës. Për sa më sipër duke qenë se nga ana e Operatorit tonë janë paraqitur argumentet lidhur me këtë procedurë, konform parashikimeve ligjore paraqesim ankimin tonë lidhur me vendimin e AK-së Bashkia Durrës.....

Duke qenë se kemi kemi qenë pjesëmarrës në shumë procedura me vlerë të madhe ku ofertues ka qenë dhe OE Ervin Luzi i cili është kualifikuar ...jemi të bindur se OE Ervin Luzi me dokumentacionin e dorëzuar në procedurë prokurimi ka dhënë një indicie që plotëson kriterin 2.2.2 dhe se referuar nenit 82 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik. ...

AK ka gabuar në shqyrtimin e ankimit të OE IT Gjergji Kompjuter, ky ankim duhet rrëzuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra nga vetë ky i fundit.

Sa më sipër, kërkojmë mospranimin e ankimit të OE dhe qëndrimin e tij të skualifikuar, duke lënë në fuqi vendimin e KVO-se, për shpalljen fitues të OE Librari Dyrrahu shpk.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Librari Dyrrahu” ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.6, ka vendosur mbi moslegjitimitimin e OE “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për të paraqitur ankesë si edhe

shfuqizimin e Vendimit të KSHA-së për pranimin e ankesës dhe si rrjedhojë gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke përmbushur interesin e ligjshëm të operatorit ekonomik ankimues “Librari Dyrrahu” ShPK.

Përsa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Loti II** me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “Blerje tonera ”, me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KSHA-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

